REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 79, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI 2-9 KATE ME 1 KAT NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË LAGJEN HAJRO ÇAKËRRI, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të Nenit 40 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Nenit 18/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Triumf HD" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes të Ndërtimit për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimi 2-9 kate me 1 kat nëntokë, me vendndodhje në lagjen Hajro Çakërri, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Triumf HD" sh.p.k., miratuar me Vendimin Nr. 7/58, datë 07.09.2010 të KRRT-së.

2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 31/08/ 2026